

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 133/2013, datë “Për sistemin e Pagesave”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Financave
<b>FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Finale
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Harmonizim me Acquis-in e BE-së në fushën e pagesave
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Rregullorja (BE) 2024/886 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 mars 2024, për ndryshimin e Rregulloreve (BE) nr. 260/2012 dhe (BE) 2021/1230 dhe Direktivave 98/26/EC dhe (BE) 2015/2366, për transfertat e menjëhershme të kreditit në euro (Instant Payments Regulation), vetëm për nenin 4.
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Plani i masave për plotësimin e Piketave Mbyllëse të Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	05/04/2026 – 01/06/2026
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	24/06/2026
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	Po,  02/06/2026
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	2026 – MF - 5
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> (Maksimumi 2 faqe)	

- ***Jepni kontekstin e politikës***

Kuadri ligjor për sistemet e pagesave dhe finalitetin e shlyerjes në Shqipëri është zhvilluar në mënyrë progresive, në përputhje me modernizimin e sistemit financiar, forcimin e stabilitetit të tregut dhe procesin e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, baza kryesore ligjore përbëhet nga:

- **Ligji nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”**, i cili përcakton:
  - funksionimin e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes;
  - rregullat për pjesëmarrjen në këto sisteme;
  - parimin e finalitetit të urdhrave të pagesës dhe mbrojtjen juridike të tyre në sistemet e shlyerjes.
- **Ligji nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”**, i përafruar me Direktivën (BE) 2015/2366 (PSD2), i cili rregullon:
  - ofruesit e shërbimeve të pagesave (bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike);
  - të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave;
  - transparencën, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit në pagesa;
  - aksesin në llogari dhe shërbimet e hapura (open banking).
- **Ligji 8269/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”**, i ndryshuar, i cili ndërmjet të tjerash e mandaton Bankën e Shqipërisë me detyrën të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave. Banka e Shqipërisë
  - operon sisteme pagesash dhe të shlyerjes
  - mbikëqyr sistemin e pagesave
  - nxjerr rregulla dhe procedura për shlyerjen e pagesave dhe për përdorimin e instrumenteve të pagesave

Në nivel nënligjor, Banka e Shqipërisë ka miratuar një sërë rregulloresh që mbështesin funksionimin e sistemeve të pagesave dhe mbikëqyrjen e tyre, përfshirë:

- Rregullore për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe **AIPS**;
- Rregullore për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël **AECH**;
- Rregullore për funksionimin e sistemit **AIPS EURO për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në euro**;
- Rregullore për **debitimin direkt**;
- Rregullore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit të pagesave
- Rregullore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve; etj.

Ky kuadër ligjor dhe rregullator është ndërtuar në mënyrë graduale, duke reflektuar zhvillimin e infrastrukturës financiare, rritjen e kompleksitetit të tregut dhe nevojën për garantimin e stabilitetit financiar. Banka e Shqipërisë ka luajtur rol qendror në krijimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe shlyerjes në vend.

Zhvillimet teknologjike dhe rritja e kërkesës për pagesa më të shpejta, më të sigurta dhe më efikase kanë nxjerrë në pah nevojën për modernizim të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe institucional. Në këtë drejtim, krijimi i infrastrukturës për pagesa të menjëhershme dhe zgjerimi i aksesit për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave përbën një prioritet strategjik, në funksion të reduktimit të përdorimit të parasë fizike dhe rritjes së efikasitetit të tregut.

Në nivel të Bashkimit Evropian, Direktiva 98/26/EC për finalitetin e shlyerjes (Settlement Finality Directive – SFD) ka vendosur bazat për sigurinë juridike të urdhrave të pagesës dhe reduktimin e rrezikut sistematik në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve. Këto parime janë reflektuar në legjislacionin shqiptar që prej vitit 2013 përmes ligjit nr. 133/2013.

## **PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT**

*Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?*

Natyra e problemit është e natyrës juridike ku me ndryshimet që i bëhen Ligjit “Për shërbimet e pagesave” krijohet një mospërputhje me Ligjin ekzistues “Për sistemin e pagesave” përsa i përket konceptit të ‘pjesëmarrësit’ në sistemet e pagesave. Problemi është mungesa e koherencës ndërmjet kuadrit ligjor që rregullon sistemet e pagesave dhe atij që rregullon shërbimet e pagesave.

Rregullorja (BE) 2024/886 sjell ndryshime si në Direktivën (EU) 2015/2366 “Për shërbimet e pagesave”, ashtu edhe në Direktivën 98/26/EC “Për finalitetin e shlyerjes”. Për këtë arsye, ndryshimet që po reflektohen në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” kërkojnë njëkohësisht harmonizim edhe të ligjit nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, me qëllim shmangien e mospërputhjeve ndërmjet dy kuadrove ligjore kombëtare. Mospërputhja është vetëm për konceptin e ‘pjesëmarrësit’ në sisteme. Ndryshimet në ligjin për shërbimet e pagesave i lejojnë institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të marrin pjesë në sistem, ndërsa ligji për sistemin e pagesave nuk e parashikon këtë pjesëmarrje. Në këto kushte, subjektet e tregut dhe autoritetet mbikëqyrëse mund të përballen me interpretime të ndryshme mbi statusin e pjesëmarrësve në sistemet e pagesave, procedurat e shlyerjes dhe elementet që lidhen me finalitetin e pagesave. Këto paqartësi krijojnë rrezik për zbatim jo të njëtrajtshëm të ligjit, pasiguri juridike dhe vështirësi operacionale në funksionimin e sistemeve të pagesave.

Për shkak se problematika e identifikuar lidhet kryesisht me terminologjinë e konceptit pjesëmarrës në sisteme pageash, dhe jo me strukturën e përgjithshme të ligjit, është vlerësuar se ndërhyrja më e përshtatshme është amendimi i targetuar i pjesës së përkufizimeve.

### ***Identifikoni shkaqet e problemit***

Ligji “Për shërbimet e pagesave” është rishikuar për të qenë në përputhje të plotë me Direktivën Evropiane PSD2 dhe reflekton të gjitha ndryshimet që i janë bërë direktivës që prej vitit 2020. Një prej këtyre ndryshimeve vjen nga Rregullorja (BE) 2024/886 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 mars 2024 që ndryshon Rregulloren (BE) 260/2012 dhe (BE) 2021/1230 dhe Direktivat (KE) 98/26 dhe (BE) 2015/2366 për transfertat e kreditit të menjëhershme në euro. Rregullorja (BE) 2024/886 në vetvete bën amendime të njëkohshme të disa akteve, përfshirë Direktivën (BE) 2015/2366 (ose PSD2) dhe Direktivën (KE) 98/26 për finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve. Kjo për shkak se zbatimi i ndryshimeve të parashikuara në Direktivën e PSD2 (që janë reflektuar në projektligjin për ndryshimet e ligjit “Për shërbimet e pagesave”), kërkon ndryshimin e Direktivës (KE) 98/26 për finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve (e cila është e përafuar në ligjin “Për sistemin e pagesave”).

Me të njëjtën analogji, ndryshimet që i bëhen ligjit 55/2020 për të qenë në përputhshmëri të plotë me PSD2, kërkojnë ndryshim edhe në ligjin 133/2013 për ato ndryshime që derivojnë nga Rregullorja (BE) 2024/886. Konkretisht, kjo rregullore parashikon ndryshime në PSD2 duke lejuar të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të kenë akses në sisteme pagesash të cilat funksionojnë mbi parimin e finalitetit të shlyerjes. Ndërsa më parë, pjesëmarrës të këtyre sistemeve mund të ishin vetëm bankat, tashmë edhe institucionet e pagesave apo institucionet e parasë elektronike mund të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në to. Ky parashikim është reflektuar në ndryshimet që i bëhen ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Rrjedhimisht, ndryshimi duhet reflektuar edhe në ligjin 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, duke bërë të mundur lejimin e këtyre institucioneve si pjesëmarrës në sistemet e pagesave që funksionojnë mbi parimin e finalitetit të shlyerjes.

Ligji aktual nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave” është ndërtuar mbi bazën e standardeve dhe terminologjisë së kuadrit të mëparshëm evropian, të cilat në disa raste nuk pasqyrojnë më plotësisht zhvillimet e fundit të *acquis* të Bashkimit Evropian. Për pasojë, disa nga përkufizimet ekzistuese rezultojnë të pjesshme ose jo plotësisht të harmonizuara me konceptet e reja të legjislacionit evropian, duke krijuar nevojën për përditësim dhe harmonizim.

Procesi i integritimit evropian përbën gjithashtu një faktor të rëndësishëm që ka nxitur nevojën për këtë ndërhyrje ligjore. Republika e Shqipërisë ka detyrimin të përafrojë gradualisht legjislacionin kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të integritimit. Në këtë kontekst, harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionit financiar dhe të pagesave me standardet evropiane është një element i domosdoshëm për avancimin e këtij procesi dhe për garantimin e funksionimit të një tregu financiar të sigurt, modern dhe të integruar me praktikatat evropiane.

Përveç aspektit juridik, zhvillimet teknologjike në sektorin financiar dhe rritja e përdorimit të shërbimeve digjitale të pagesave kanë nxjerrë në pah nevojën për një kuadër ligjor më të qartë dhe më të harmonizuar. Modernizimi i tregut financiar dhe integrimi me standardet evropiane të pagesave kërkojnë që legjislacioni kombëtar të jetë i përshtatur me modelet bashkëkohore të

funksionimit të sistemeve të pagesave dhe të mbështesë inovacionin, sigurinë dhe efikasitetin e tyre.

### ***Përshkruani shtrirjen e problemit***

Problematika e identifikuar ka një shtrirje në kuadrin juridik dhe operacional të sistemeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë, pasi lidhet drejtpërdrejt me bazën e kategorive që janë pjesëmarrëse në infrastrukturën e pagesave dhe proceset e shlyerjes. Mospërditimi i problemit krijon:

- **Paqartësi në interpretim dhe zbatim.** Përkufizimet ekzistuese për pjesëmarrësit në sisteme pagesash sipas ligjit aktual nuk janë plotësisht të harmonizuara me terminologjinë dhe konceptet e reja të legjislacionit të Bashkimit Evropian, të cilat janë transpozuar nëpërmjet ndryshimeve të propozuara në Ligjin “Për shërbimet e pagesave”. Kjo mund të sjellë interpretime të ndryshme nga institucionet financiare, operatorët e sistemeve të pagesave dhe autoritetet mbikëqyrëse, duke krijuar pasiguri juridike dhe vështirësi në zbatimin e njëtrajshëm të dispozitave ligjore. Në praktikë, mungesa e qartësisë në përkufizime mund të ndikojë në mënyrën e trajtimit të pjesëmarrësve në sistemet e pagesave dhe në zbatimin e procedurave të shlyerjes.
- **Rrezik ligjor për pjesëmarrësit e tregut.** Mospërditimi i kuadrit ligjor rrit rrezikun juridik për subjektet që operojnë në tregun e pagesave, përfshirë bankat, institucionet financiare, operatorët e sistemeve të pagesave dhe institucionet e pagesave. Pasiguria mbi mënyrën e interpretimit të disa koncepteve ligjore mund të krijojë vështirësi në zbatimin praktik të detyrimeve rregullatore dhe të ndikojë në sigurinë juridike të transaksioneve dhe proceseve të shlyerjes.
- **Vështirësi në mbikëqyrjen dhe administrimin e sistemeve të pagesave.** Mospërputhja ndërmjet terminologjisë së përdorur në legjislacionin kombëtar mund të krijojë vështirësi edhe për autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe administrimin e sistemeve të pagesave, veçanërisht në lidhje me interpretimin e roleve të pjesëmarrësve, procedurave të shlyerjes dhe elementeve që lidhen me finalitetin e pagesave.

### ***Identifikoni grupet e prekura nga ky problem***

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë preken drejtpërdrejt për shkak të përgjegjësisë së tyre në hartimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor. Problemi prek drejtpërdrejt Bankën e Shqipërisë në cilësinë e autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemeve të pagesave. Një kuadër ligjor që nuk reflekton plotësisht zhvillimet më të fundit të legjislacionit mund të krijojë vështirësi në procesin e mbikëqyrjes, interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore.

Problemi prek drejtpërdrejt **sistemet ndërbankare të pagesave** dhe proceset e shlyerjes së transaksioneve ndërmjet institucioneve financiare. Përkufizimet që lidhen me pjesëmarrësit në sistemin, operatorët, procedurat e transferimit dhe finalitetin e shlyerjes përbëjnë elemente thelbësore për funksionimin korrekt dhe të sigurt të këtyre sistemeve. Mospërditimi i terminologjisë mund të krijojë paqartësi në interpretimin e roleve dhe përgjegjësisë të pjesëmarrësve, sidomos në rastet që lidhen me pjesëmarrjen indirekte në sistemet e pagesave

dhe me procedurat e pagesave të menjëhershme. Kjo mund të ndikojë në mënyrën e administrimit të transaksioneve dhe në sigurinë juridike të proceseve të shlyerjes.

Problemi i identifikuar prek drejtpërdrejt institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, të cilat përbëjnë aktorë kyç në zhvillimin e tregut modern të pagesave. Këto subjekte operojnë në një mjedis dinamik dhe në zhvillim të vazhdueshëm, ku kërkesa për qartësi juridike mbi kushtet dhe mënyrën e pjesëmarrjes në sistemet e pagesave është thelbësore për funksionimin e tyre të qëndrueshëm dhe efikas.

Në kushtet e kuadrit aktual, pa ndërhyrjet e propozuara, këto institucione përballen me kufizime në aksesin e drejtpërdrejtë në sistemet e pagesave me finalitet shlyerjeje, si dhe me pasiguri lidhur me statusin e tyre juridik si pjesëmarrës potencialë. Kjo situatë mund të pengojë zhvillimin e plotë të aktivitetit të tyre, të kufizojë konkurrencën në treg dhe të ngadalësojë integrimin e tyre në infrastrukturën financiare kombëtare.

Ndërhyrjet e synuara kanë për qëllim krijimin e një kuadri të qartë ligjor dhe funksional që mundëson përfshirjen e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike në sistemet e pagesave me finalitet shlyerjeje, duke forcuar kështu efikasitetin e tregut dhe duke rritur nivelin e konkurrencës.

Nga ana tjetër, mungesa e këtyre përshtatjeve rregullatore ndikon edhe te operatorët e sistemeve të pagesave, të cilët përballen me vështirësi në menaxhimin e një kategorie pjesëmarrësish që nuk është e plotësuar qartësisht në kuadrin ekzistues ligjor. Kjo krijon nevojën për masa përshtatëse dhe rregullatore, me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt, efikas dhe të harmonizuar të sistemeve të pagesave.

Përveç operatorëve dhe institucioneve financiare, nga këto problematika preken edhe qytetarët si përdorues fundorë të shërbimeve të pagesave. Çdo paqartësi apo mosfunksionim në sistemet e pagesave mund të reflektohet në vonesa në ekzekutimin e transaksioneve, ulje të besimit në përdorimin e pagesave elektronike dhe kufizim të përfitimeve që vijnë nga shërbimet moderne të pagesave, përfshirë shpejtësinë, sigurinë dhe efikasitetin e tyre.

## **ARSYEJA E NDËRHYPJES**

*Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë*

Kuadri strategjik kombëtar në fushën e financave publike dhe zhvillimit ekonomik përcakton qartë drejtimet kryesore të reformave në sistemin e pagesave. **Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (PFM)** synon reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi, nxitjen e pagesave elektronike në sektorin publik dhe privat, si dhe forcimin e transparencës dhe formalizimit fiskal. Ndërkohë, **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian** vendos si prioritet modernizimin e sistemit financiar, përsheptimin e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e shërbimeve të pagesave dhe mbështetjen e zhvillimit të një tregu digjital, konkurrues dhe të integruar.

Në këtë kuadër strategjik, nevoja për ndërhyrje rrjedh nga ndryshimet e ndërmarra në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili është rishikuar me qëllim përafrimin e plotë me

Direktivën (BE) 2015/2366 (PSD2), duke reflektuar gjithashtu zhvillimet më të fundit të kuadrit rregullator evropian që prej vitit 2020.

Një zhvillim i rëndësishëm në këtë drejtim është **Rregullorja (BE) 2024/886 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit**, e cila ndryshon njëkohësisht disa akte të rëndësishme të Bashkimit Evropian, përfshirë Rregulloren (BE) nr. 260/2012, Rregulloren (BE) 2021/1230, si dhe Direktivat (KE) 98/26 dhe (BE) 2015/2366, me qëllim lehtësimin e transfertave të kreditit të menjëhershme në euro.

Kjo rregullore ka natyrë horizontale, pasi ndërhyt njëkohësisht në PSD2 dhe në Direktivën (KE) 98/26 për finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve. Ndërhyrja lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar koherencë ndërmjet rregullave të aksesit në sistemet e pagesave dhe atyre që rregullojnë sigurinë juridike të shlyerjeve, duke kërkuar harmonizim të mëtejshëm të kuadrit ligjor.

Në këtë kontekst, ndryshimet e PSD2, të reflektuara në ligjin nr. 55/2020, kërkojnë domosdoshmërisht përshtatje edhe në ligjin nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, i cili transponon Direktivën (KE) 98/26. Kjo ndërhyrje është e nevojshme për të shmangur mospërputhjet ndërmjet dy ligjeve kombëtare që rregullojnë aspekte të ndërlidhura të tregut të pagesave dhe për të garantuar koherencën e kuadrit ligjor në tërësi.

Në mënyrë të veçantë, Rregullorja (BE) 2024/886 zgjeron aksesin në sistemet e pagesave me finalitet shlyerjeje, duke mundësuar pjesëmarrjen jo vetëm të bankave, por edhe të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike. Ky ndryshim është reflektuar në ligjin nr. 55/2020 dhe, për rrjedhojë, duhet të pasqyrohet edhe në ligjin nr. 133/2013, përmes përshtatjes së përkufizimeve të “institucionit financiar” dhe “pjesëmarrësit”, me qëllim përfshirjen e këtyre subjekteve në sistemet përkatëse.

Në mungesë të këtyre ndërhyrjeve, do të krijohej mospërputhje ndërmjet dy ligjeve kombëtare, duke cenuar koherencën e kuadrit rregullator dhe duke sjellë vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e tij nga subjektet e tregut dhe autoritetet mbikëqyrëse.

Mospërshtatja e përkufizimeve do të krijonte gjithashtu pasoja praktike dhe juridike, përfshirë paqartësi në interpretimin e të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve, vështirësi operacionale për operatorët e tregut dhe institucionet financiare, si dhe sfida për autoritetet mbikëqyrëse në zbatimin e unifikuar të rregullave. Për më tepër, kjo situatë do të pengonte modernizimin e mëtejshëm të infrastrukturës së pagesave dhe integrimin e saj me standardet evropiane, veçanërisht në drejtim të pagesave të menjëhershme.

#### *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes*

Ndërhyrja është e kufizuar dhe e orientuar, pasi synon vetëm rishikimin e përkufizimeve pa prekur strukturën e përgjithshme të ligjit. Kjo e bën atë proporcionale, efikase dhe me kosto minimale.

*Shpjegoni si mbështet kjo ndërhyrje objektivat e qeverisë*

Kjo ndërhyrje, edhe pse e kufizuar në amendimin e përkufizimeve, mbështet drejtpërdrejt objektivat strategjikë të qeverisë në disa drejtime të rëndësishme:

- Procesi i integrimit evropian

Duke harmonizuar Ligjin “Për sistemin e pagesave” me Rregulloren (BE) 2024/886 dhe Direktivën 98/26/EC, Shqipëria bën një hap konkret drejt përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian. Ky veprim demonstroi angazhimin e qeverisë për të përmbushur kriteret e integrimit dhe për të siguruar që legjislacioni kombëtar të jetë në përputhje me standardet e BE-së. Në këtë mënyrë, ndërhyrja shërben si një instrument praktik për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit.

- Modernizimi i sistemit financiar

Amendimi i përkufizimeve nuk është thjesht një rregullim formal, por një hap drejt modernizimit të sistemit financiar. Përkufizimet e harmonizuara reflektojnë zhvillimet më të fundit evropiane në fushën e pagesave dhe shlyerjeve, duke mundësuar që institucionet financiare shqiptare të operojnë sipas praktikave bashkëkohore. Kjo rrit efikasitetin e sistemeve të pagesave, përmirëson transparencën dhe lehtëson integrimin e teknologjive të reja.

- Rritja e sigurisë juridike

Një nga përfitimet më të dukshme është qartësia ligjore. Përkufizimet e harmonizuara eliminojnë paqartësitë dhe kontradiktat midis ligjeve, duke siguruar një bazë të fortë për interpretim dhe zbatim. Kjo rrit besueshmërinë e kuadrit ligjor, ul rrezikun e mosmarrëveshjeve dhe krijon një mjedis më të sigurt për institucionet financiare, bizneset dhe qytetarët.

*Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një proces të gjerë reformash në fushën e pagesave, me synim modernizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit në tregun e pagesave, promovimin e inovacionit financiar dhe harmonizimin progresiv me *acquis* të Bashkimit Evropian. Këto reforma kanë qenë pjesë e objektivave strategjikë të vendit për zhvillimin e tregut financiar, reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi dhe avancimin e procesit të integrimit evropian. Në këtë kuadër, asistencat teknike e ofruar nga Banka Botërore ka qenë veçanërisht e rëndësishme për analizimin e kuadrit ekzistues, identifikimin e boshllëqeve ligjore dhe përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Përmes projekteve të mbështetura nga Banka Botërore, janë realizuar vlerësime të tregut të pagesave, janë hartuar rekomandime për zhvillimin e pagesave elektronike dhe janë mbështetur institucionet shqiptare në ndërtimin e një kuadri modern rregullator dhe mbikëqyrës.

Një arritje e rëndësishme e këtij procesi ishte miratimi i Ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili përbën një nga reformat më të rëndësishme në tregun financiar shqiptar. Ky

ligj u hartua duke reflektuar në masë të konsiderueshme parimet dhe kërkesat e Direktivës (BE) 2015/2366 për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm (PSD2), duke krijuar bazën ligjore për hyrjen e aktorëve të rinj në treg, nxitjen e konkurrencës, zgjerimin e gamës së shërbimeve të pagesave dhe forcimin e mbrojtjes së përdoruesve të këtyre shërbimeve. Ligji gjithashtu vendosi bazat për zhvillimin e shërbimeve inovative të pagesave dhe për zbatimin e standardeve më të avancuara të sigurisë në pagesat elektronike.

Një tjetër moment i rëndësishëm në procesin e harmonizimit me *acquis* ka qenë avancimi i Shqipërisë drejt integritimit në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA). Përfshirja e Shqipërisë në SEPA përbën një zhvillim strategjik për sistemin financiar dhe ekonominë e vendit, pasi krijon mundësinë që pagesat në euro të kryhen sipas të njëjtave standarde, procedura dhe kushte si në vendet e Bashkimit Evropian. Ky proces ka kërkuar jo vetëm përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me standardet evropiane, por edhe përmbushjen e kërkesave teknike, operacionale dhe institucionale të përcaktuara nga skemat evropiane të pagesave.

Përgatitjet për integrimin në SEPA kanë përfshirë reforma të shumta në fushën e pagesave, forcimin e mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimeve të pagesave, përmirësimin e kuadrit për mbrojtjen e konsumatorit dhe përshtatjen e infrastrukturës së tregut financiar me standardet evropiane. Këto zhvillime pritet të sjellin përfitime të rëndësishme për qytetarët, bizneset dhe ekonominë shqiptare në tërësi, duke reduktuar kostot e pagesave ndërkufitare, duke rritur shpejtësinë e ekzekutimit të transaksioneve dhe duke lehtësuar integrimin ekonomik me tregun evropian.

Në vijim të këtij procesi reformues, Shqipëria po vijon përafrimin e legjislacionit të saj me zhvillimet më të fundit të *acquis* në fushën e pagesave, përfshirë dispozitat e Rregullores (BE) 2024/886 mbi transfertat e menjëhershme të kreditit. Kjo reformë përfaqëson hapin e radhës në modernizimin e tregut të pagesave dhe synon të garantojë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave në Shqipëri të përfitojnë nga shërbime më të shpejta, më të sigurta dhe më efikase, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe objektivat e integritimit evropian të vendit. Dy nene të kësaj rregulloreje që sjellin ndryshime në direktivat 2015/2366 dhe 98/26 (përafruar përkatësisht me Ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe me Ligjin “Për sistemin e pagesave”) janë transpozuar në projektligjet që ndryshojnë Ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe Ligjin “Për sistemin e pagesave”. Ky i fundit është në proces rishikimi tërësor me qëllim përafrimin e plotë të tij me Direktivën 98/26 KE.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit?*

Përmes projektligjit të propozuar synohet realizimi i këtyre objektivave kryesore:

1. Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e sistemeve të pagesave, në kuadër të procesit të integritimit evropian.

2. Saktësimi dhe zgjerimi i përkufizimi i “institucionit financiar” me përfshirjen e kategorive të subjekteve që operojnë në sistemet e pagesave, me qëllim eliminimin e paqartësive dhe rregullimin e plotë të tregut.
3. Harmonizimi i ligjit “Për sistemin e pagesave” me ligjin “Për shërbimet e pagesave”, me qëllim garantimin e konsistencës ligjore.
4. Garantimi i një qasje të njëjtë në sistemet e pagesave për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave duke krijuar kushte të barabarta dhe duke nxitur konkurrencën e drejtë, krijimin e produkteve inovative, uljen e kostove për shërbimet e pagesave dhe nxitjen e përfshirjes financiare.
5. Zgjerimi i pjesëmarrësve në sisteme me finalitet shlyerje, duke krijuar kushtet e nevojshme për nxitjen e inovacionit dhe konkurrencës në tregun e pagesave të menjëhershme, si dhe duke promovuar përdorimin e instrumenteve të pagesave të menjëhershme nga individët, bizneset dhe institucionet publike.
6. Mbështetja e procesit të digjitalizimit të ekonomisë dhe modernizimit të infrastrukturës kombëtare të pagesave, nëpërmjet rritjes së përdorimit të pagesave elektronike dhe reduktimit të kostove dhe kohës së ekzekutimit të transaksioneve.
7. Sigurimi që ofruesit e shërbimeve të pagesave, të cilët ofrojnë shërbimin e transfertave të kreditit, të mundësojnë edhe dërgimin dhe marrjen e transfertave të menjëhershme të kreditit. Në këtë formë, të garantojë aksesin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave në instrumentet e transfertave të menjëhershme të kreditit në çdo kohë dhe pa ndërprerje.
8. Përmirësimi i efikasitetit, shpejtësisë dhe sigurisë së ekzekutimit të pagesave elektronike, në funksion të rritjes së besimit të publikut në instrumentet moderne të pagesave.
9. Mbështetja e politikave të qeverisë shqiptare për reduktimin e përdorimit të parasë fizike dhe zgjerimin e pagesave elektronike, të realizuara përmes ofruesve të licencuar nga Banka e Shqipërisë.

## ***OPSIONET***

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.*

Lidhur me ndryshimet e propozuara në Ligjin për sistemin e pagesave, opsionet e mundshme janë përmbledhur më poshtë:

### **Opsioni 0 – Status quo**

#### **Mos ndryshimi i kuadrit ligjor ekzistues**

Ky opsion konsiston në ruajtjen e pandryshuar të ligjit nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, pa reflektuar ndryshimet dhe zhvillimet e fundit që burojnë nga përditësimet në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” dhe nga acquis i Bashkimit Evropian. Në këtë rast, sipas këtij opsioni kuadri ekzistues do të vijonte të zbatohet në formën aktuale, pa ndërhyrje për

harmonizim terminologjik apo përditësim konceptual, duke mbështetur funksionimin aktual të sistemeve të pagesave mbi bazën e dispozitave në fuqi.

Ky opsion është i papranueshëm pasi krijon mospërputhje ndërmjet ligjit “Për sistemin e pagesave” dhe ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, duke cenuar koherencën e kuadrit ligjor. Ai rrit rrezikun e paqartësive interpretative dhe zbatimit jo të njëtrajtshëm të dispozitave ligjore nga subjektet e tregut dhe autoritetet mbikëqyrëse dhe krijon pasiguri juridike për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave dhe të ndikojë negativisht në funksionimin e proceseve të shlyerjes;

### **Opsioni 1 – Masa jorregullatore**

Ky opsion parashikon trajtimin e problematikave të identifikuara pa ndërmarrë ndryshime në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke u përqendruar në përmirësimin e zbatimit të dispozitave ekzistuese dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale.

Në këtë kuadër, ndërhyrjet do të mbështeten kryesisht në masa administrative dhe operacionale, të orientuara drejt rritjes së efektivitetit të mekanizmave ekzistues, përmes:

- forcimit të proceseve të mbikëqyrjes dhe kontrollit nga autoritetet përgjegjëse;
- përmirësimin të praktikave të zbatimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional;
- zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për rritjen e njohurive mbi kërkesat dhe detyrimet në fuqi;
- ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes trajnimit të stafit të institucioneve mbikëqyrëse dhe pjesëmarrësve në treg.

### **Avantazhet**

- **Zbatim i menjëhershëm dhe fleksibil** – nuk kërkon procedura të gjata ligjberëse, duke mundësuar ndërhyrje të shpejta për adresimin e problematikave.
- **Kosto më e ulët rregullatore** – shmang kostot që lidhen me ndryshimet ligjore dhe përshtatjen formale të kuadrit nga subjektet.

### **Disavantazhet**

- **Nuk adreson boshllëqet ligjore në thelb** – nëse problematika buron nga vetë kuadri ligjor, ky opsion mbetet i pamjaftueshëm.
- **Efektivitet i kufizuar në afatgjatë** – përmirësimet administrative nuk garantojnë zgjidhje të qëndrueshme pa ndërhyrje ligjore.

Avantazhi i këtij opsioni është se ai mund të zbatohet në mënyrë të shpejtë pa qenë nevoja për procedura për amendime apo nxjerrje të akteve juridike. Por ka disavantazhin kryesor që nuk është i mjaftueshëm për të adresuar problematikat që lidhen me përkufizimet bazë të ligjit, të cilat kërkojnë ndryshim në nivel ligjor dhe jo vetëm interpretim. Për këto arsye, ky opsion është vlerësuar si i papërshtatshëm.

## **Opsioni 2 – Ndryshime të targetuara ligjore (opsioni i preferuar)**

Ky opsion konsiston në amendimin e përkufizimeve ekzistuese në Ligjin nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, me qëllim harmonizimin e tyre me ndryshimet e propozuara në Ligjin “Për shërbimet e pagesave”, si dhe me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren (BE) 2024/886 dhe Direktivën 98/26/EC.

Ndërhyrja është e kufizuar dhe e targetuar, duke u fokusuar vetëm në përditësimin e atyre përkufizimeve që paraqesin nevojë për harmonizim me kuadrin e ri kombëtar dhe atë evropian, pa ndërhyrë në strukturën dhe dispozitat thelbësore të ligjit ekzistues. Kjo qasje siguron një përafrim të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshëm të legjislacionit, duke forcuar koherencën ndërmjet akteve ligjore që rregullojnë fushën e pagesave dhe duke eliminuar paqartësitë terminologjike që ndikojnë në zbatimin praktik.

### **Avantazhet:**

- Garanton koherencë ndërmjet ligjit “Për sistemin e pagesave” dhe ligjit “Për shërbimet e pagesave”;
- Siguron harmonizim të drejtpërdrejtë dhe të qartë me legjislacionin kombëtar dhe me *acquis* të Bashkimit Evropian;
- Rrit sigurinë juridike dhe qartësinë në interpretimin e dispozitave ligjore;
- Përmirëson funksionimin e sistemeve të pagesave dhe proceseve të shlyerjes duke reflektuar zhvillimet më të fundit evropiane;
- Është një ndërhyrje proporcionale me natyrën dhe qëllimin e ndryshimeve të nevojshme, ku ndërhyrja është e kufizuar vetëm në përkufizime dhe nuk prek strukturën thelbësore të ligjit;

### **Disavantazhet:**

- Kërkon procedura legjislativë për miratimin e amendimeve;
- Mund të kërkojë përshtatje teknike ose operationale nga institucionet financiare dhe autoritetet përgjegjëse gjatë fazës së zbatimit;
- Ka karakter të kufizuar ndërhyrjeje, duke mos adresuar ndryshime më të gjera që mund të lindin nga zhvillimet e ardhshme të kuadrin evropian;

Këto disavantazhe konsiderohen të kufizuara dhe proporcionale në raport me përfitimet që sjell harmonizimi ligjor. Për këtë arsye, ky opsion është vlerësuar si alternativa më e përshtatshme dhe më efektive.

## **Opsioni 3 – Hartimi i një ligji të ri**

### **Miratimi i një ligji të ri për sistemet e pagesave**

Ky opsion parashikon shfuqizimin e ligjit aktual dhe hartimin e një ligji të ri të plotë për sistemet e pagesave.

**Avantazhet:**

- Do të mundësonte një rishikim të plotë dhe modernizim të të gjithë kuadrit ligjor në fushën e sistemeve të pagesave;
- Mund të krijonte një strukturë të re ligjore më të konsoliduar dhe të përshtatur me zhvillimet afatgjata të tregut financiar;
- Do të ofronte mundësinë për integrimin e plotë të koncepteve dhe standardeve më të avancuara evropiane në një akt të vetëm ligjor.

**Disavantazhet:**

- Kërkon kohë, burime administrative dhe angazhim institucional shumë më të madh.
- Mund të krijojë vonesa të konsiderueshme në procesin e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian, për shkak të kompleksitetit të hartimit dhe miratimit të një ligji të ri;
- Ekziston rreziku i mospërputhjes kohore dhe normative me ligjin “Për shërbimet e pagesave”, i cili është aktualisht në proces finalizimi, duke sjellë pasiguri në harmonizimin e kuadrit ligjor;
- Mund të cenojë stabilitetin dhe parashikueshmërinë rregullatore gjatë periudhës së tranzicionit, për shkak të zëvendësimit të një kuadri ekzistues me një strukturë tërësisht të re;
- Mund të rezultojë në ndërhyrje më të gjerë sesa është e nevojshme për adresimin e ndryshimeve specifike të kërkuara nga legjislacioni i BE-së, duke e bërë opsionin më pak proporcional në raport me objektivin rregullator.

Për këto arsye, ky opsion është konsideruar jo i nevojshëm dhe jo proporcional.

**ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.*

Më poshtë janë identifikuar grupet mbi të cilat janë analizuar ndikimet e ndryshimeve ligjore të propozuara në Ligjin “Për sistemin e pagesave”.

1. Banka e Shqipërisë, e cila është autoriteti mbikëqyrës dhe operator i sistemeve kombëtare të pagesave

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti institucional, rregullator dhe operacional.

Ndikime pozitive:

- Rritje e qartësisë juridike lidhur me kategoritë e subjekteve që mund të marrin pjesë në sistemet e pagesave;
- Forcimi i kompetencave për vlerësimin e rrezikut sistematik dhe përcaktimin e subjekteve që mund të trajtohen si “institucione financiare” ose “pjesëmarrës”;
- Përmirësim i kapaciteteve mbikëqyrëse mbi sistemet me rëndësi sistematike;

- Harmonizim më i plotë i kuadrit rregullator me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën për Finalitetin e Shlyerjes (SFD) dhe Direktivën për Shërbimet e Pagesave (PSD2).

Ndikime potenciale:

- Shtim i ngarkesës mbikëqyrëse, analitike dhe administrative;
- Nevojë për analiza më të detajuara dhe procese më komplekse në vlerësimin e rrezikut sistematik.

## 2. Bankat dhe institucionet e kreditit

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti financiar, rregullator, konkurrues.

Ndikime pozitive:

- Qartësim i statusit të tyre si “institucion” brenda sistemeve të pagesave;
- Rritje e sigurisë juridike në lidhje me pjesëmarrjen dhe veprimtarinë në këto sisteme;
- Forcim i sigurisë dhe stabilitetit të transaksioneve përmes zbatimit më efektiv të parimit të finalitetit të shlyerjes.

Ndikime potenciale:

- Mundësi për rritje të kërkesave në fushën e përputhshmërisë rregullatore (compliance);
- Rritje e konkurrencës dhe presione për reduktimin e kostove në ofrimin e shërbimeve të pagesave

## 3. Institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti ekonomik, konkurrues dhe akses në treg.

Ndikime pozitive:

- Mundësi për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në sistemet e pagesave; përmirësim i aksesit në infrastrukturën kombëtare të pagesave;
- Nxitje e konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave;
- Mbështetje për zhvillimin e pagesave elektronike dhe pagesave të menjëhershme (instant payments).

Sfida:

- Rritje e kërkesave lidhur me kapitalin, menaxhimin e rrezikut dhe garancitë financiare;
- Kosto për përshtatjen e proceseve teknike dhe operacionale;
- Nevojë për forcimin e kapaciteteve të brendshme në fushën e përputhshmërisë dhe teknologjisë së informacionit.

## 4. Shoqëritë komisionere dhe tregjet e kapitalit

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti rregullator dhe ndërsektorial.

Ndikime pozitive:

- Përmirësim i integritetit ndërmjet tregjeve financiare dhe sistemeve të pagesave;

- Qartësim i rolit dhe statusit të tyre si pjesëmarrës të mundshëm në sistem.

Ndikime të tjera:

- Mund të kërkohej përshtatje me kërkesa të reja operacionale në rast përfshirjeje në sistemet e pagesave;
- Rritje e kompleksitetit të kërkesave rregullore ndërmjet sektorëve të ndryshëm financiarë.

#### 5. Operatorët e sistemeve të pagesave

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti operacional, teknik dhe rregullator.

Ndikime pozitive:

- Zgjerim i bazës ligjore për përfshirjen e kategorive të reja të pjesëmarrësve, përfshirë institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike;
- Rritje e sigurisë juridike në administrimin dhe menaxhimin e pjesëmarrësve;
- Krijim i mundësive për zhvillimin e sistemeve më moderne, më efikase dhe më gjithëpërfshirëse.

Ndikime të tjera/sfida:

- Rritje e kompleksitetit në administrimin e pjesëmarrësve dhe proceseve operacionale;
- Nevojë për përditësimin e rregullave të funksionimit dhe të infrastrukturës teknike;
- Rritje e rrezikut operacional gjatë periudhës së tranzicionit.

#### 6. Subjektet e huaja (banka dhe institucione financiare të huaja)

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti juridik dhe ndërkombëtar.

Ndikime pozitive:

- Lehtësim i pjesëmarrjes së institucioneve të huaja në sistemet shqiptare të pagesave;
- Harmonizim më i mirë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e finalitetit të shlyerjes.

Ndikime neutrale.

- Nuk pritet të sjellë ndryshime të drejtpërdrejta në strukturën e tregut, por kontribuon në rritjen e sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike.

#### 7. Ekonomia dhe sistemi financiar në tërësi

Llojet e ndikimeve janë identifikuar nga aspekti makroekonomik dhe stabilitet financiar.

Ndikime pozitive:

- Rritje e stabilitetit dhe sigurisë së sistemeve të pagesave;
- Ulje e rrezikut sistematik përmes qartësimit të statusit dhe rolit të pjesëmarrësve;
- Përmirësim i efikasitetit të proceseve të shlyerjes;
- Nxitje e digjitalizimit, inovacionit dhe modernizimit të tregut të pagesave;
- Rritje e përputhshmërisë së legjislacionit vendas me acquis të Bashkimit Evropian.

- Rritje e konkurrencës, reduktim i kostove dhe rritje e eficiencës në ofrimin e shërbimeve të pagesave, përfshirë ofrimin e pagesave të menjëhershme.
- Rritje e përfshirjes financiare nëpërmjet ofrimit të pagesave nga një grup më i gjerë institucionesh.

Ndikime afatshkurtra:

- Kosto të përkohshme për përshtatjen e proceseve dhe sistemeve nga aktorët e tregut;
- Nevojë për një periudhë tranzicioni dhe përshtatje ndaj kërkesave të reja rregullatore.

### **Vlerësim i përgjithshëm**

Ndryshimet e propozuara në përkufizimet e “institucionit” dhe “pjesëmarrësit” pritet të kenë ndikim kryesisht rregullator dhe strukturor, duke:

- zgjeruar bazën e pjesëmarrësve në sistemet e pagesave;
- forcuar kuadrin ligjor që garanton finalitetin e shlyerjes;
- rritur nivelin e harmonizimit me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.

Në tërësi, ndikimet pozitive pritet të jenë më të theksuara në afatin e mesëm dhe afatgjatë, ndërsa kostot e identifikuara kanë karakter kryesisht tranzitor dhe operacional.

Edhe pse ndryshimet e propozuara janë të fokusuara kryesisht në përditësimin dhe amendimin e përkufizimeve ligjore, ndikimi i tyre shtrihet në mënyrën e organizimit, administrimit dhe funksionimit praktik të sistemeve të pagesave, si dhe të të gjithë aktorëve që marrin pjesë në to.

Projektligji krijon mundësi për përfshirjen e aktorëve të rinj në sistemet e pagesave me finalitet shlyerjeje, duke zgjeruar bazën e pjesëmarrësve dhe duke rritur konkurrencën në treg. Në mungesë të këtyre ndryshimeve, do të krijohesh një mospërputhje ndërmjet kuadrit ligjor të sistemit të pagesave dhe atij të shërbimeve të pagesave, veçanërisht në raport me ndryshimet e fundit të miratuara në këtë të fundit.

Duke qenë se sistemet e pagesave përbëjnë një element thelbësor të infrastrukturës financiare të vendit, çdo paqartësi ose mospërputhje në terminologjinë dhe rregullimin ligjor mund të ketë pasoja më të gjera në stabilitetin, efikasitetin dhe sigurinë e tregut financiar në tërësi.

### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.*

Opsioni i preferuar është **amendimi i dy përkufizimeve** ekzistuese në Ligjin për sistemin e pagesave për t'i harmonizuar me ndryshimet e propozuara në Ligjin për shërbimet e pagesave dhe në përputhje me ato në Rregulloren (BE) 2024/886 dhe Direktivën 98/26/EC.

Ky opcion konsiston në ndërhyrje të kufizuar dhe të targetuar në ligjin nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, duke amenduar vetëm përkufizimet që kërkojnë harmonizim me kuadrin e ri kombëtar dhe atë evropian.

Ky opcion synon të sigurojë koherencë të plotë midis kuadrin ligjor kombëtar dhe atij evropian. Në thelb ai targeton vetëm elementët terminologjikë të cilët janë të domosdoshëm për të shmangur mospërputhjet dhe paqartësitë midis ligjeve kombëtare. Kjo qasje e kufizuar e bën procesin proporcional me natyrën e ndryshimeve të kërkuara, duke ruajtur stabilitetin e sistemit ligjor dhe duke shmangur komplikime të panevojshme.

Ky është opsioni i preferuar pasi adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë problematikën e identifikuar, konkretisht nevojën për harmonizimin e përkufizimeve ligjore me ndryshimet e që po i bëhen Ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Ndërhyrja e propozuar kufizohet vetëm në dispozitat që kërkojnë përditësim. Opsioni i preferuar siguron koherencë ndërmjet ligjit “Për sistemin e pagesave” dhe ligjit “Për shërbimet e pagesave”, duke shmangur mospërputhjet që mund të krijonin pasiguri juridike në praktikë. Gjithashtu, përmes këtij opsioni arrihet përafrimi i legjislacionit shqiptar me nenin 4 të rregullores (BE) 2024/886.

Një nga arsyet kryesore për zgjedhjen e këtij opsioni lidhet me faktin se problematika e identifikuar është kryesisht e natyrës terminologjike dhe jo strukturore apo institucionale. Në thelb ai targeton vetëm elementët terminologjikë të cilët janë të domosdoshëm për të shmangur mospërputhjet dhe paqartësitë midis ligjeve kombëtare. Kjo qasje e kufizuar e bën procesin proporcional me natyrën e ndryshimeve të kërkuara, duke ruajtur stabilitetin e sistemit ligjor dhe duke shmangur komplikime të panevojshme.

#### **Avantazhet e qasjes**

- **Koherencë ligjore:** Ligji “Për sistemin e pagesave” do të jetë në përputhje të plotë me Ligjin “Për shërbimet e pagesave”, duke eliminuar çdo kontradiktë.
- **Harmonizim evropian:** Përkufizimet e reja reflektojnë drejtpërdrejt *acquis* të BE-së, duke e afruar Shqipërinë me standardet e integritimit evropian.
- **Siguri juridike:** Interpretimi i dispozitave ligjore bëhet më i qartë, duke reduktuar rrezikun e keqkuptimeve apo zbatimit të pasaktë.
- **Përmirësim funksional:** Sistemet e pagesave dhe proceset e shlyerjes pasqyrojnë zhvillimet më të fundit evropiane, duke rritur efikasitetin dhe besueshmërinë.
- **Proporcionalitet:** Ndërhyrja është e kufizuar vetëm në përkufizime, duke shmangur barrën e panevojshme për institucionet financiare dhe autoritetet.

#### **Disavantazhet e mundshme**

- **Procedura legjislative:** Miratimi i amendimeve kërkon kalimin nëpër proceset parlamentare, që mund të zgjasë në kohë.
- **Përshtatje teknike:** Institucionet financiare dhe autoritetet përgjegjëse mund të kenë nevojë për disa rregullime teknike ose operacionale gjatë zbatimit.

Ky opcion nuk kërkon krijimin e institucioneve të reja, ndryshim të strukturave ekzistuese apo investime të konsiderueshme financiare.

Për vlerësimin e opsionit të preferuar, janë identifikuar pesë kritere kryesore për të vlerësuar efektivitetin, përputhshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjes ligjore. Këto kritere janë vlerësuar me pikë për secilin opcion si vijon:

<b>Kriteret</b>	<b>Pesha</b>	<b>Opsioni 0</b>	<b>Opsioni 1</b>	<b>Opsioni 2</b>	<b>Opsioni 3</b>
<b>Harmonizimi i kuadrit ligjor vendas</b>	5	0(0)	0(0)	4(20)	4(20)
<b>Harmonizimi me <i>acquis</i></b>	4	0(0)	0(0)	4(16)	4(16)
<b>Përmirësimin e funksionimit të sistemeve të pagesave</b>	4	1 (4)	1(4)	4(16)	4(16)
Kosto-efektiviteti	5	1(5)	1(5)	4(20)	3(15)
<b>Pikët</b>		<b>9</b>	<b>9</b>	<b>72</b>	<b>67</b>

Bazuar në vlerësimin e secilit opcion në raport me kriteret e përcaktuara, rezulton se opsioni 2 ka numrin më të lartë të pikëve 72 pikë, duke u vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm.

Nisur nga avantazhet e referuara më sipër, ky opcion konsiderohet si zgjidhja më e përshtatshme dhe e balancuar për adresimin e problematikave të identifikuara, pasi siguron një kombinim optimal ndërmjet efektivitetit rregullator dhe proporcionalitetit të ndërhyrjes. Për më tepër, ndërhyrja e targetuar ruan stabilitetin e sistemit ekzistues dhe lehtëson zbatimin praktik, duke e bërë këtë opcion jo vetëm të domosdoshëm për harmonizim, por edhe më efikas dhe më të qëndrueshmin në perspektivë afatmesme dhe afatgjatë.

<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>	<b>Viti 3</b>
<b>Nuk aplikohet</b>	<b>Nuk aplikohet</b>	<b>Nuk aplikohet</b>

## **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)*

Projektligji u publikua në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike gjatë periudhës 04.05.2026 - 01.06.2026, duke plotësuar afatin minimal prej 20 ditë pune që parashihet në ligj dhe ku në përfundim të kësaj periudhe nuk pati komente nga konsultimi në

platformë. Gjatë periudhës së konsultimit publik, projektligji regjistroi 231 shikime në Regjistrin Elektronik.

Projektligji është konsultuar drafti me asistencën teknike të Bankës Botërore, me qëllim reflektimin e ekspertizës së tyre për formulimin sa më të saktë të ndryshimeve ligjore.

Është komunikuar paraprakisht aktorët e tregut financiar mbi iniciativën për ndryshimet ligjore që do të lejojnë përfshirjen e jobankave në sistemet e pagesave.

Gjithashtu metodat e tjera të konsultimit publik të përdorura, përveç RENJK për këtë projektligj janë si vijon: Shkresë zyrtare, email; si dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

Numri i palëve të përfshira:

Banka: (11)

1. Banka Amerikane e Investimeve
2. Banka Credins
3. Banka e Bashkuar e Shqipërisë
4. Banka e Parë e Investimeve Albania
5. Banka Intesa Sanpaolo Albania
6. Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka OTP Albania
8. Banka ProCredit
9. Banka Raiffeisen
10. Banka Tirana
11. Banka Union

Institucione të pagesave (4):

1. AK Invest sh.a
2. MPay sh.p.k
3. RAEA Financial Services sh.p.k
4. SHKK Fed Invest

Institucione të parasë elektronike (10):

1. Unioni Financiar Tiranë sh.a
2. Posta Shqiptare sh.a
3. Easypay sh.p.k
4. Paysera Albania sh.p.k
5. eReja sh.p.k

6. Rpay sh.p.k
7. Rubicon sh.a
8. Iute Pay sh.p.k
9. BKT Pay sh.a
10. Happy Pay sh.a

#### Publiku i gjerë

Gjatë këtij procesi referuar metodave të tjera të konsultimit publik ka pasur 3 komente nga subjektet e referuara si më lartë, të cilat ishin kërkesa për sqarim dhe për të cilat janë dhënë sqarimet përkatëse.

#### **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?*

Zbatimi do të realizohet nga:

- a. Banka e Shqipërisë- institucion përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor.
- b. Institucionet financiare dhe operatorët e sistemeve të pagesave;

#### **Pengesat e mundshme:**

- OSHP jo banka mund të përballen me vështirësi në përmbushjen e kërkesave të reja që lidhen me kapitalin, menaxhimin e rrezikut dhe garancitë financiare të nevojshme për pjesëmarrje në sistemet e pagesave.
- Përshtatja e sistemeve teknike dhe proceseve operacionale me kërkesat e infrastrukturës së pagesave mund të sjellë kosto shtesë financiare dhe organizative, veçanërisht për institucionet me kapacitete më të kufizuara.
- Mund të evidentohen mungesa në kapacitetet e brendshme profesionale, veçanërisht në fushën e menaxhimit të rrezikut, përputhshmërisë rregullatore (*compliance*) dhe teknologjisë së informacionit.
- Gjatë fazës fillestare të zbatimit mund të ketë paqartësi operacionale ose nevojë për interpretim të njëtrajtshëm të kërkesave të reja nga subjektet e tregut.

#### **Masat për kapërcimin e pengesave:**

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve të nevojshme për të siguruar qartësi mbi kriteret e pjesëmarrjes dhe kërkesat rregullatore të zbatueshme.
- Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet Bankës së Shqipërisë, operatorëve të sistemeve të pagesave dhe institucioneve të prekura për të adresuar në kohë çështjet praktike të zbatimit.

- Organizimi i aktiviteteve informuese dhe trajnuese për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, me fokus në kërkesat e menaxhimit të rrezikut, përputhshmërisë dhe sigurisë operationale.
- Mbështetja e proceseve të modernizimit teknologjik dhe përshtatjes operationale përmes planifikimit gradual të implementimit dhe koordinimit me operatorët e sistemeve të pagesave.

Në tërësi, pengesat e identifikuar vlerësohen si të menaxhueshme dhe kryesisht të karakterit operational e tranzitor, ndërsa masat e parashikuara pritet të lehtësojnë zbatimin efektiv të ndryshimeve dhe arrijen e objektivave të projektligjit.

#### **Masat monitoruese:**

- Vendosja e një mekanizmi të rregullt raportimi nga institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike pranë Bankës së Shqipërisë mbi progresin e përputhshmërisë me kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore.
- Monitorimi i funksionimit të sistemeve të pagesave në lidhje me pjesëmarrjen e subjekteve të reja jobanka dhe ndikimin e tyre në stabilitetin dhe efikasitetin operational.
- Koordinim i vazhdueshëm ndërinstitutional ndërmjet Bankës së Shqipërisë, operatorëve të sistemeve të pagesave dhe subjekteve të tregut për identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave të zbatimit.
- Ndjekja e zhvillimeve rregullatore të Bashkimit Evropian për të siguruar përshtatjen e vazhdueshme të kuadrit vendas me standardet përkatëse.

#### **Kriteret dhe treguesit e monitorimit:**

- Numri i institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike që përmbushin kërkesat për pjesëmarrje në sistemet e pagesave.
- Niveli i përputhshmërisë me kërkesat për kapital, menaxhim rreziku dhe garanci financiare, i vlerësuar gjatë procesit të mbikëqyrjes.
- Shkalla e incidenteve operationale apo teknike të raportuara në sistemet e pagesave që përfshijnë subjektet e reja pjesëmarrëse.
- Koha mesatare e përshtatjes së subjekteve për përmbushjen e kërkesave të reja rregullatore.
- Niveli i aksesit të subjekteve jobanka në sistemet e pagesave dhe rritja e volumit të transaksioneve të realizuara prej tyre.
- Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve të identifikuar gjatë inspektimeve mbikëqyrëse dhe shkalla e adresimit të tyre brenda afateve të përcaktuara.

Në tërësi, këta tregues synojnë të vlerësojnë efektivitetin e zbatimit të ndryshimeve ligjore, nivelin e përputhshmërisë së subjekteve të tregut dhe ndikimin e përgjithshëm në stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
<b>Kosto në total</b>										
<b>Kosto e zbritur në total</b> = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim (ndryshimi I primit)										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
<b>Përfitimi në total</b>										
<b>Përfitimi i zbritur në total</b> = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
<b>Vlera aktuale e kostos në total</b>										
<b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>										
<b>Vlera aktuale neto (VAN)</b> = Vlera aktuale e përfitimit në total –										

Vlera aktuale e kostos në total	
------------------------------------	--

**Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b**

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

**MINISTRI I FINANCAVE**

**PETRIT MALAJ**